



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 544.Prot

Elbasan më 02.07.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele.

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë “; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “, të Udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024 Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të Institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar të personelit, duke u bazuar në shkresën nr.530.prot, date 01.07.2026 ‘Dorëheqje nga detyra’, paraqitur nga Z.Renato Haxhiaj me detyrë Specialist i Sektorit të Administrimit.

Ofruesi publik i AFP-së Qendrës së Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Specialist/e i Sektorit të Administrimit të Formimit Profesional

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave

- penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
  - e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
  - f) Të demostrojë aftësi të punes ne grup dhe te motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) Aftësi të tjera nësë kërkohen.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije:
  - letermotivimin për pozicionin;
  - jetëshkrimin ( CV-në)
  - kartën e indentitetit
  - diplomë
  - librezë e punës
  - çdo dukumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
  - çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
  - vërtetim të gjendjes shendetesore
  - vërtetimin të gjendjes gjyqësore
  - vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
  - rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
  - dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
2. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofruesit publik të AFP-së brënda datës 10.07.2026

**DREJTOR**  
**Krenar XHEMALI**

